



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 04.07.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“ PËR RININË”

- ***Hyrje***

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjet e zhvilluara në datë **03.07.2019 dhe në datën 04.07.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “ ***Për rininë***”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Arsimit, Sportit dhe Kulturës, e përfaqësuar nga Znj. Lorena Haxhiu, Zëvendësministre

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Kulturës, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj, sipas nenit 1 të tij ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të rinjve të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti, nëpërmjet:

- a) mbrojtjes së të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- b) përcaktimit të funksioneve dhe të kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike si dhe të rolit të organizatave që ushtrojnë veprimtari për dhe në fushën e rinisë;
- c) krijimit të kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- **Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së**
Ky projektligj nuk përafrohet pjesërisht legjislacionin e Bashkimit Europian

Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me prioritetet e përcaktuara në **PKIE 2019 - 2021, Kapitulli 19 “Politika sociale dhe punësimi”**.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Acquis e BE-së që lidhet me fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor i BE-së dhe akte të tjera të BE-së që nuk janë ligjërish të detyrueshme (i.e akte *soft-law*).
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimin të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit Europian;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- **Traktati mbi Funkionimin e Bashkimit Europian (TFBE):** Pjesa e Parë, “Parimet”, Titulli I “Kategoritë dhe Fushat e Kompetencës së Bashkimit Europian”, **neni 6**; Pjesa e Tretë “Politikat dhe Veprimet e Brendshme të Bashkimit”, Titulli XII “Arsimi, Formimi Profesional, Rinia dhe Sporti”, **Neni 165** (ish-Neni 149 i TKE), **Neni 166** (ish-neni 150 i TKE).
- **Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, Neni 32** “Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e të rinjve në vendin e punës”, **Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit BE-Shqipëri (MSA):** Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, **Neni 100** “Arsimi dhe trajnimi

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Rezoluta e Këshillit, datë 27 nëntor 2009 “Mbi një kuadër të rinovuar për bashkëpunimin Europian në fushën e rinisë (2010-2018)”** (2009/C 311/01), Numri CELEX: 32009G1219(01), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr. 311, datë 19.12.2009, fq. 1-11.
- **Konkluzionet e Këshillit “Mbi maksimalizimin e potencialit të politikave për rininë në realizimin e objektivave të Strategjisë Europa 2020”** (2013/C 224/02), Numri CELEX:

52013XG0803(01), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr. 224, datë 3.8.2013, fq. 2-6.

- **Konkluzionet e Këshillit “Mbi promovimin e aksesit të të rinjve në të drejtat e tyre me qëllim për të forcuar autonominë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë civile”** (2015/C 18/01), Numri CELEX: 52015XG0121(01), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr. 18, datë 21.1.2015, fq. 1-4.
- **Konkluzionet e Këshillit “Mbi forcimin e koordinimit të politikave ndërsektoriale për të adresuar në mënyrë efektive sfidat ekonomiko - sociale me të cilat përballet rinia”,** (2015/C 172/02), Numri CELEX: 52015XG0527(01), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr. 172, datë 27.05.2015, fq. 3-7.
- **Rezoluta e Këshillit dhe e Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare, të mbledhur në Këshill “Mbi një Plan Pune të Bashkimit Europian për Rininë për periudhën 2016-2018”,** (2015/C 417/01), Numri CELEX: 42015Y1215(01), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr. 417, datë 15.12.2015, fq. 1-9.

Neni 6, shkronja “e” i TFBE-së parashikon se BE-ja ka *kompetencë plotësuese* në fushën e *rinisë*. Kjo do të thotë se në këtë fushë BE-ja ka kompetencë vetëm për të mbështetur, bashkërenduar dhe plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare. Kjo kompetencë plotësuese e BE-së shoqërohet me ndalimin për të kryer harmonizimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në këtë fushë (pika 4 e neneve 165 dhe 166 të TFBE-së). Në këtë fushë Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë *masa stimuluese* dhe *rekomandime*, të cilat nuk janë ligjërish të detyrueshme për Shtetet Anëtare (i.e janë akte *soft-laë*), por kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuar në nenet 165 dhe 166 të TFBE-së lidhur me *rininë*.

Pika 2 e nenit 165 të TFBE-së parashikon qëllimet e veprimit të BE-së në fushën arsimit, *rinisë* dhe sportit. **Nënpika e pestë e pikës 2 të nenit 165 të TFBE-së** parashikon se veprimi i BE-së në fushën e rinisë ka për qëllim:

- *nxitjen e zhvillimit të shkëmbimeve të të rinjve dhe të shkëmbimeve të instruktorëve shoqëroro - edukativë, dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike në Europë.*

Ndërsa **pika 4 e nenit 165 të TFBE-së** parashikon se për arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë nen Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë *masa stimuluese*, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare dhe Këshilli miraton *rekomandime*.

Pika 2 e nenit 166 të TFBE-së parashikon qëllimet e veprimit të BE-së në fushën **formimit profesional**. **Nënpika e tretë e pikës 2 të nenit 165 të TFBE-së** parashikon se veprimi i BE-së në fushën e **formimit profesional të rinisë** ka për qëllim:

- *lehtësimin e pjesëmarrjes në formimin profesional dhe nxitjen e lëvizjes së instruktorëve dhe pjesëmarrësve në formim dhe në veçanti të të rinjve.*

Ndërsa, **pika 4 e nenit 166 të TFBE-së** parashikon se për arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë nen, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratojnë *masa*, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare, dhe Këshilli miraton *rekomandime*.

Neni 32 “*Ndalimi i punës së fëmijve dhe mbrojtja e të rinjëve në vendin e punës*” i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European parashikon se të rinjtë që merren në punë duhet të kenë kushte pune të përshtatshme për moshën e tyre dhe të jenë të mbrojtur prej shfrytëzimit ekonomik dhe prej çdo pune që mund të dëmtojë sigurinë, shëndetin ose zhvillimin e tyre fizik, mendor, moral ose social apo që mund të pengojë arsimimin e tyre.

Neni 100 i MSA-së “Arsimi dhe trainimi” parashikon bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe BE-së me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në këtë fushë.

Gjithashtu BE-ja përmes akteve soft-laë në fushën e rinisë (Rekomandimeve të Këshillit lidhur me Rininë; Komunikatave të Komisionit European lidhur me Rininë, Konkluzioneve të Këshillit lidhur me Rininë; Rezolutave të Këshillit lidhur me Rininë), kontribuon në arritjen e objektivave të përcaktuar në nenet 165 dhe 166 të TFBE-së lidhur me rininë, duke zhvilluar dhe forcuar dimensionin european lidhur me rininë.

Niveli i Përafrimit: nuk ka

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur nuk mund të përcaktohet përderisa nuk ka akte të detyrueshme të *acquis* të BE-së.

• Konsultimi publik

1. Shoqëria civile dhe grupe te interesit

- a. Kongresi Rinor Kombëtar
 - i. Lorela Marku - Presidente e Kongresit Rinor Kombëtar
 - ii. Irena Topalli - Organizata Pertej Barrierave
 - iii. Vladimir Thanu - Organizata Pro - Youth.
 - b. Znj. Kristi Qendro Organizata ADRA
 - c. Klaudio Pulaha, Qendra e të Drejtave të Fëmijëve - CRCA/ECPAT Shqipëri
 - d. Linda Pino, Koalicioni për Arsimin në Shqipëri
 - e. Ervjola Osmanaj, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri
 - f. Mirgjit Vataj, Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111
 - g. Benson Begaj, EESTEC Tirana
- Enkli Sefa, Child and Youth Policy Hub.

• Efektet financiare të aktit

Projektligji parashikon burimet e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim krahas planifikimeve e parashikimeve të buxhetit të shtetit. Njëkohësisht parashikon 15

edhe burime të tjera të ligjshme financimi si të ardhurat e gjeneruara nga veprimtaria e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj. Në kuadër të financimit, projektligji parashikon financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve, mënyrat e financimit dhe zërat konkretë të financimit. Nëpërmjet kriterëve të propozuara synohet rritja e aktivizimit rinor dhe rritja e bashkëveprimit ndërmjet organizatave rinore me qëllim bashkimin

e njohurive dhe potencialeve si dhe krijimin e sinergjive për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Këto subjekte do të mbështeten me financime nga buxheti i shtetit dhe buxhetet vendore. Projektligji parashikon edhe krijimin e personave juridikë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat më pas mund të marrin pjesë në thirrjet e hapura për projektet rinore dhe aplikojnë për mbështetje nga projektet kombëtare e ndërkombëtare.

- ***Diskutimi në komision***

Nga komisioni u vlerësua bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit të cilët paraqiten mendimet e tyre në mbledhjen e datës 03.07.2019.

- ***Rekomandime***

Nuk ka

Përfundim

- Komisioni për Integrimin Europian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
- pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe pa ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI